



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA SUPREME

Numri i lëndës: 2022:080812  
Datë: 19.09.2024  
Numri i dokumentit: 06183448

ARJ.nr.112/2024

GJYKATA SUPREME NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Ragip Namani, kryetar, Nebojša Borčić dhe Zenel Leku, anëtar, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Zanë Buçinca, procesmbajtëse, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit B.R., nga P., sipas autorizimit e përfaqëson Arbër Krasniqi, avokat nga Prishtina, kundër të paditurit Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (KPM SHCK), në Prishtinë, e përfaqëson A.B., - Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, me bazë juridike anulim vendimi të organit të paditur A.nr.128/2022 të datës 15.03.2022, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor të paditësit, ushtruar nga i autorizuari i tij, kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit - Departamenti për Çështje Administrative në Prishtinë, AA.nr.681/2023 të datës 13.06.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 18 Shtator 2024, merr këtë:

**A K T G J Y K I M**

Refuzohet si e pa bazuar kërkesa për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, e paditësit B.R., kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit - Departamenti për Çështje Administrative në Prishtinë, AA.nr.681/2023 të datës 13.06.2024.

**A r s y e t i m**

Me aktgjykimin e atakuar të Gjykatës së Apelit, AA.nr.681/2023 të datës 13.06.2024, është vendosur si në vijim: **REFUZOHET** si e pabazuar ankesa e paditësit B.R., e datës 04.09.2023, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative A.nr.972/2022 i datës 16.08.2023, **VËRTETOHET**.

Kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, paditësi, për mes të autorizuarit të lartë cekur, në afat ligjor në këtë gjykatë parashtron kërkesë për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, me të cilën e konteston ligjshmërinë e të njëjtit për shkak të: shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës administrative, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të drejtës materiale, me propozim të: **APROVOHET** në tërësi e bazuar kërkesa për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor dhe të **ANULOHET** Aktgjykimi i Gjykatës

Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative A.nr.972/2022 të datës 16.08.2023 dhe Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës AA.nr.681/2023 të datës 13.06.2024, dhe lënda ti kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim dhe rivendosje.

Gjykata Supreme, në bazë të nenit 53 të Ligjit për Konfliktet Administrative, ka mbajtur seancën e kolegjit dhe pas vlerësimit të aktgjykimit të atakuar, dhe atij të shkallës së parë, sipas kërkesës së paditësit dhe shqyrtimit edhe të akteve tjera të lëndës gjen se:

Kërkesa për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se me Vendimin e të paditurit, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës i Shërbimit Civil të Republikës së Kosovës në Prishtinë (KPMSHCK) A.nr.128/2022 të datës 15.03.2022, në pikën I. Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.128/2022 e datës 14.02.2022 e parashtruar nga ankuesi B.R., Në pikën II. Mbetet në fuqi Vendimi me Nr.0027/2022 i datës 24.01.2022 i Këshillit Shtetëror për Vlerësim dhe Disiplinë.

Në arsyetim të këtij vendimi ndër të tjera theksohet se: Në bazë të shkresave të lëndës, ankuesi nuk ka arritur të dëshmoj se për gjatë periudhës mars - nëntor 2021 (përfshirë kohën sa ka qenë duke u trajtuar për shkak të COVID-19), është evidentuar në librin e vijueshmërisë në punë ose në regjistrin elektronik, ndërsa në bazë të provave të lëndës nuk ka asnjë dëshmi që ankuesi është evidentuar në librin e vijueshmërisë në punë, ndërsa sipas email-it të datës 11.06.2021, të gjithë Kryeshefat Ekzekutiv të Agjencive në kuadër të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë janë të pajisur me ID kartelat e vijueshmërisë në punë. Po ashtu theksohet se: paditësi ka bërë shkelje disiplinore siç parashihet me nenin 8 paragraf 2 të Rregullores (QRK) Nr.12/2020 për Orarin e Punës dhe Pushimet e Zyrtarëve Publik, siç parashihet në nenin 46 paragraf 2 nën paragrafi 2.1, paragrafi 3, 3.5 dhe 3.10, të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik. Po ashtu i njëjti nuk ka përmbushur në tërësi detyrimet e tij të përcaktuara nga neni 8, 9 dhe 10 të Ligjit Nr.06/L-019 për Standardizim, kështu që ka bërë shkelje të nenit 46 paragraf 3, nën paragraf 3.1, të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik. Duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe provat e bashkëngjitura në lëndë, kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave duke u bazuar në nenin 6 paragraf 1, nën paragraf 1.1 dhe neni 18 paragraf 1 nën paragraf 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të tij.

Kundër vendimit të lartë cekur të KPMSHCK paditësi me padi fillon konflikt administrativ. Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin, A.nr.972/2022, të datës 16.08.2023, në dispozitiv ka vendosur si në vijim: I. REFUZOHET kërkesëpadia e paditësit B.R.,-P., kundër të paditurës Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (KPMSHCK), me të cilën ka kërkuar të anulohet vendimin i të paditurës A.nr.128/2022 datë 15.03.2022 dhe vendimi nr.0027, i datës 24.01.2022, të detyrohet e paditura që paditësin ta kthej në punë në pozitën kryeshef i Agjencisë Kosovare të Standardeve, si dhe ti kompensohen pagat dhe shtesat që i takojnë me ligj sikur të kishte punuar nga data e largimit, në shumën prej 10,663.52 Euro (dhjetë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e tri euro dhe pesëdhjetë e dy cent), në emër të pagave të pa paguara si pasojë e ndërprerjes së marrëdhënies së punës, kjo vlerë e përgjithshme përfshinë edhe pagesat e trustit pensional dhe vlerës 8%, nga dita kur është paraqitur padia, si dhe të detyrohet e paditura

në kompensimin e shpenzimeve të procedurës kontestimore sipas detyrimit të të paditurës, si e pa bazuar. II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

Gjykata e shkallës së parë në aktgjykimin e saj arsyeton ndër të tjera se: Gjykata fillimisht kishte parasysh pozitën e këtu paditësit e cila pozitë referuar dispozitave të Ligjit për Zyrtarët Publik nuk përjashtohet nga pozita e nëpunësve civil. Gjykata kishte parasysh Ligjin për Zyrtarët Publik, nenin 45 ku përcaktohen përgjegjësia disiplinore. Neni 46 par. 3 të Ligjit për Zyrtarët Publik ku përcaktohet: *3.5. braktisja e punës ose mungesa e paarsyeshme dhe e vijueshme për pesë (5) ditë pune apo më shumë; 3.10. shkelja e detyrimeve të përcaktuara në këtë ligj dhe në legjislacionin në fuqi;* Neni 47 par. 1 nën par. 14 ku përcaktohet: *1. Masat disiplinore, të cilat mund të zbatohen ndaj nëpunësit civil, janë: 1.4. largimi nga Shërbimi Civil.* Neni 48 par. 3 ku përcaktohet: *“3. Masat disiplinore të parashikuara në paragrafin 1.2 deri 1.4 të nenit 47 të këtij ligji, janë në kompetencën e komisionit disiplinor, si dhe neni 50 par. 1 nën par. 1.2 dhe par. 2 ku përcaktohet: 1. Për përcaktimin e masës disiplinore të zbatueshme, mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë ose komisioni disiplinor bazohet në: 1.2. shkallën e fajësisë; 2. Masat disiplinore jepen në raport të drejtë me shkeljen e kryer”.*

Tutje theksohet se: Bazuar në provat në shkresat e lëndës, paditësi nuk ka arritur të arsyetoj vijueshmërinë, evidentimin/regjistrimin për periudhën mars - nëntor 2021, andaj rrjedhimisht me mos regjistrimin e vijueshmërisë në punë, e paditura me të drejtë ka konstatuar se paditësi nuk ka dëshmuar prezencën në vendin e punës, e që provat e tilla dhe argumentet lidhur me prezencën në punë paditësi nuk ka arritur ti dëshmoj edhe para gjykatës. Po ashtu lidhur me konstatimet si në vendimin e atakuar lidhur me përmbushjen e detyrave të punës dhe atë procedimi i draft rregullores për Nostrifikimin e Standardeve në kuadër të AKS, po ashtu rreth propozimit të anëtarëve të Këshillit Profesional për Standardizim, i njëjti para Gjykatës nuk ka arritur të provoj të kundërtën e këtyre të gjeturave dhe konstatimeve si në vendimin e atakuar me padi. Lidhur me përmbushjen e detyrave të përcaktuara në nenin 8, 9 dhe 10 të Ligjit nr.06/L-19, bazuar në raportet e vitit 2020 dhe 2021, paditësi nuk ka provuar përmbushjen e detyrave në raport me performancën e përshkruar në këto raporte. Mbi këtë bazë duke pasur parasysh se edhe para Gjykatës paditësi nuk ka ofruar prova me të cilat do të mbështeste vijueshmërinë brenda orëve të përcaktuara të punës konstatohet se më të drejtë e paditura ka aplikuar dispozitat nga neni 46 par. 2.1 dhe par. 3.5.

Gjykata e shkallës së parë, duke ju referuar kërkesës së komunikimit elektronik të datës 06.08.2021 për procedimin e rregullores për nostrifikimin e standardeve në kuadër të AKS, nga email-i i datës 11.08.2021 konstatohet dërgimi i projekt Rregullores për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në ASK. Po ashtu në kuptim të nenit 9 par 4 të Ligjit nr.06/L-019 paditësi edhe para Gjykatës nuk ka arritur të dëshmoj përmbushjen e detyrimit ligjor lidhur me propozimin e anëtarëve të KPS. Po ashtu referuara provës së raportit të realizimit të planit të punës AKS 2020 dhe raporti 2021 konstatohet dallimi i performancës referuar Agjencisë Kosovare të Standardizimit. Nga provat në shkresat e lëndës konstatohen raporte javore të periudhës 10.12.2021-17.12.2021, 03.12.2021-10.12.2021, 26.11.2021-03.12.2021, andaj bazuar këtyre provave paditësi nuk ka dëshmuar raportimin e rregullt dhe atë vjetor referuar periudhës së marrëdhënies së punës bazuar në hierarkinë përkatëse, duke vepruar

në kundërshtim me nenin 23 të Ligjit 06/L-113 për Organizimin dhe Funksonimin Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, mbi këtë bazë Gjykata konstaton se me të drejtë e paditura referohet në nenin 46 par. 3.10 të Ligjit për Zyrtarët Publik.

Gjykata e Apelit me aktgjykimin e kontestuar me kërkesë, duke vendosur sipas ankesës së palës paditëse në kuptim të nenit 49 dhe 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative (LKA)-së dhe 194 dhe 200 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK)-së, vendosi si në dispozitiv të aktgjykimit të saj si më lartë. Në arsyetim pasi bën përshkrimin e gjendjes faktike të vërtetuar nga gjykata e shkallës së parë, bazuar në shkaqet dhe arsyet e njëjta, qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë e pranon në tërësi si të drejtë dhe ligjor, duke vlerësuar se gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë dhe drejtë është aplikuar e drejta materiale me refuzimin e kërkesëpadisë së paditësit.

Gjykata e shkallës së dytë tutje ndër të tjera thekson se, në raport me pretendimin e të autorizuarit të paditësit në ankesë se, është bërë cenim i rëndë i dispozitave të LPK respektivisht nenit 7.3 pasi që palës paditëse - ankuese në asnjë fazë të procedurës nuk ju kanë ofruar provat e paraqitura nga pala paditëse, e me këtë rast i është mohuar e drejta e deklaramit dhe kundërshtimit të këtyre provave të cilat gjykata e shkallës së parë i ka administruar si prova dhe e ka mbështetur në tërësi aktgjykimin e saj, Kolegji i Apelit e refuzoj si të pa bazuar për faktin se gjykata e shkallës së parë në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 16.08.2023, i ka administruar provat dhe në fund i ka pyetur palët ndërgjyqëse se a kanë vërejtje apo komente dhe të njëjtit nuk kanë pasur ndonjë vërejtje lidhur me administrimin e provave. I njëjti ka pasur mundësi të kërkojë nga ana e gjykatës së shkallës së parë të pajiset me provat të cilat ka pretenduar se nuk i posedon dhe krahas saj të kërkojë nga gjykata e shkallës së parë eventualisht shtyrjen e seancës për përgatitje të mbrojtjes, gjë të cilën nuk e ka bërë madje i njëjti në fjalën përfundimtare ka theksuar se *“edhe pse nuk kemi pasur në posedim provat e dorëzuara nga ana e të paditurës, në aspektin e përgatitjes së mbrojtjes apo kundërshtimit të tyre dhe elaborimit për kundër faktit se të gjitha këto prova nuk gjejnë mbështetje ligjore dhe janë në kundërshtim në vet inicimin e procedurës disiplinore”*. Andaj nga të cekurat më lartë shihet qartë se paditësi ka pranuar vazhdimin e procedurës, duke mos kërkuar dorëzimin e shkresave të munguara edhe për kundër faktit dhe pretendimit se nuk i posedon të gjitha shkresat e lëndës, e nga kjo rrjedh se i njëjti është pajtuar që procedura të vazhdohet në këtë mënyrë, përkundër kësaj paditësi ka qenë i përfaqësuar nga avokati, i cili konsiderohet se duhet ti njeh mirë procedurat gjyqësore, andaj kolegji vlerëson se paditësit nuk i është mohuar e drejta e paraparë me nenin 7 paragraf 3 i LPK-së. Andaj thënie të ankesës ky kolegji nuk i aprovoi sepse vlerësoi se pretendimet ankimore ishin pa ndikim në vërtetimin e gjendjes tjetër faktike nga ajo e vërtetuar nga gjykata e shkallës së parë.

Duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, Gjykata Supreme, pas shqyrtimit të aktgjykimit të kontestuar, akteve të lëndës dhe vlerësimit të pretendimeve në kërkesë, gjeti se gjykata e shkallës së dytë drejtë ka vepruar kur ka refuzuar si të pabazuar ankesën e paditësit dhe e ka vërtetuar aktgjykimin e shkallës së parë. Qëndrimin juridik të Gjykatës së Apelit por edhe të Gjykatës Themelore, në tërësi e aprovon edhe kjo gjykatë meqë aktgjykimet e kontestuar nuk janë të përfshirë me shkelje të dispozitave të procedurës apo të drejtës materiale, ashtu si pretendon pala paditëse në kërkesën e tij.

Aktgjykimet e kontestuara përmbajnë arsye të mjaftueshme dhe bindëse për të gjitha faktet vendimtare të vlefshme për gjykimin e drejtë të kësaj çështje, nga rezulton se drejtë është vërtetuar gjendja faktike me refuzimin si të pabazuar të kërkesë padisë së paditësit. Bazuar në provat e administruara për mes shqyrtimit verbal dhe vlerësimit të fakteve, ka rezultuar se vendimi i të paditurit, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës i Shërbimit Civil të Republikës së Kosovës në Prishtinë (KPMSHCK) A.nr.128/2022 të datës 15.03.2022, si dhe Vendimi nr.0027/2022 i datës 24.01.2022 i Këshillit Shtetëror për Vlerësim dhe Disiplinë, janë vendime të drejtë dhe të ligjshëm.

Gjykata Supreme vlerëson se vendimi i të paditurit KPMSHCK, është ligjërisht i drejtë pasi që paditësi ka bërë shkelje disiplinore nga neni 46 paragraf 2, nënparagraf 2.1, paragraf 3, 3.5 dhe 3.10 të Ligjit nr.06/L-114 për Zyrarët Publik, ngase veprimet e paditësit të konstatuara nga Këshilli Shtetëror për Vlerësim dhe Disiplinë, kualifikohen si veprime që përbëjnë shkelje të rëndë të detyrave të punës, për çka Gjykata e Supreme vlerëson se masa e shqiptuar nga punëdhënësi është proporcionale me natyrën e shkeljes, e rrjedhimisht është edhe masë e ligjshme. Pra, në rastin e ndërprerjes së marrëdhënies së punës, punëdhënësi ka zbatuar në tërësi dispozitat për procedurën disiplinore në mënyrë adekuate sipas gjendjes faktike të konstatuar në shkresat e lëndës dhe arsyetimit të paraqitur si në vendimin e organit të paditur dhe aktgjykimet e gjykatave të instancave më të ulëta.

Sa i përket pretendimeve tjera të paditësit të theksuara si në kërkesën për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, lidhur me shkeljet e dispozitave thelbësore të procedurës kontestimore nga neni 182 paragraf 2 pika n), nenit 183 dhe 184, nenit 7 të LPK-së, të cilat zbatohen përshtatshmërisht sipas nenit 60 të Ligjit për Konfliktet Administrative, si dhe nenit 5 të LKA-së, kolegji i kësaj gjykate i shqyrtoi në baza ligjore dhe vlerëson se të njëjtat nuk janë të bazuara në fakte të qëndrueshme dhe relevante, ngase gjykatat e instancave më të ulëta në mënyrë të plotë dhe të drejtë kanë vërtetuar gjendjen faktike dhe aplikuar dispozitat e procedurës gjatë shqyrtimit të kësaj çështje, deklarimit të palëve dhe pas administrimit të provave të paraqitura nga palët në seancën kryesore të mbajtur me dt. 16.08.2023. Andaj aktgjykimet e instancave më të ulëta rezultojnë se janë të qartë të kuptueshëm, dhe përmbajtjesor në arsyetimin e tyre ku janë dhënë arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare të cilat i pranon edhe kjo gjykatë.

Gjykata shqyrtoj pretendimet e parashtruesit si në kërkesë dhe gjen se të njëjtat janë shqyrtuar nga gjykatat e instancave më të ulëta, të njëjtat janë të pabazuara, të paqëndrueshme dhe të pa argumentuara, për vendosjen ndryshe në këtë çështje nga ajo e vendosur nga gjykatat e instancave më të ulëta.

Gjykata nuk shqyrtoi pretendimet e tjera të parashtruesit të kërkesës, lidhur me konstatimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, duke pasur parasysh se, sipas dispozitës së nenit 24 paragraf 2 të LKA-së, përcaktohet se: *“Kërkesa për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit mund të parashtrohet vetëm për shkak të shkeljes të drejtës materiale ose të shkeljeve të dispozitave të procedurës, që do të mund të kishte ndikim në zgjidhjen e çështjes”*.

Mbi këto arsye, Gjykata Supreme e Kosovës konsideron se pretendimet e paditësit janë të pabazuara dhe të pa ndikim për një gjendje ndryshe faktike nga ajo e vërtetuar nga gjykata e shkallës së dytë. Vendimi i kontestuar i gjykatës së shkallës së dytë është i qartë dhe i kuptueshëm. Përveç kësaj, edhe e drejta materiale është zbatuar drejtë dhe nuk është shkelur ligji në dëm të paditësit.

Nga se u theksua si më lartë, e në bazë të nenit 54 par.1 të Ligjit për Konfliktet Administrative, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME - PRISHTINË  
ARJ.nr.112/2024, më datë 18 Shtator 2024

B. Profesionale,  
Zanë Buçinca

Kryetari i Kolegjit,  
Ragip Namani